



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	04 - 11 2020	0	viti god year
Organ./Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSACK	2438/2020		1/2



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A . Nr. 277/2020

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga; Ardita Haxhnikaj–Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, si dhe Çlirim Zeka Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesës me numër A. Nr.277/2020, të datës 21.09.2020, të ankuesit [REDACTED], me adresë Komuna e Pejës, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*Kompensim Material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 03.11.2020, mori këtë:

**V E N D I M**

**HEDHET POSHTË** si e palejuar ankesa me numër A. Nr. 277/2020 e datës 21.09.2020, e parashtruar nga ankuesi [REDACTED].

**A r s y e t i m**

Ankuesit [REDACTED], i punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme në pozitën “Arkivist” në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve në Pejë, bazuar në vendimin Nr. Protokoll 02 ref. 2959 të datës 30.06.2020, të U.D Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me datë 31.07.2020 i është përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, duke i njohur të drejtën e një page në vlerën e pagës së fundit.

Ankuesi [REDACTED], i pakënaqur me këtë vendim, me datë 21.09.2020 parashtron ankesë me Nr. Protokoll 1851/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor që vendimi me Nr. Protokoll 02 ref. 2959 i datës 30.06.2020 të ndryshohet dhe ankuesit me rastin e pensionimit ti njihet e drejta për pagesë përcjellëse prej 3 ( tri) pagave mujore ashtu siç është paraparë me nenin 52 dhe 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 23.09.2020, ka dërguar kërkesën për përgjigjen në ankesë Nr. protokoll 1881/2020, tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa kjo e fundit me datën 07.10.2020 ka përcjell përgjigjen në ankesë dhe shkresat provuese.

**Administrimi i Provave** - Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 21.09.2020 e parashtruar nga ankuesi me numër protokolli 1851/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për Përgjigje në ankesë e datës 23.09.2020; Përgjigje në ankesë e datës 07.10.2020; Vendim për pensionimin e nëpunësit civil i datës 30.06.2020 nr. 02.2959 ; Lista e pagave prej datës 01.07.2020 deri më 31.07.2020; e-mailat e datës 20.10.2020 dhe 29.10.2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankuesit ██████████, është e pa lejuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në shkresat e lëndës, konstaton se vendimi 02 ref. 2959 i datës 30.06.2020 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit të ██████████ është lëshuar nga organi i punësimit me datë 30.06.2020, dhe i njëjti ka qenë i zbatueshëm nga data 31.07.2020. Ekzekutimi i një page shtesë në emër të pensionimit është bërë me datë 31.07.2020, ndërsa ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me datë 21.09.2020. Kolegji për shqyrtimin e ankesave, vlerëson se ankesa Nr. 277/2020 e datës 21.09.2020 është parashtruar jashtë afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh të përcaktuar me dispozitat e nenit 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se “Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.”


Andaj, duke marr parasysh se ankesa është parashtruar jashtë afatit ligjor, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi që ankesa Nr. 277/2020 e datës 21.09.2020, e parashtruar nga ankuesi ██████████ të hedhet poshtë si e palejuar.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër Anr.277/2020**

**Çlirim Zeka**  
  
**Procesmbajtës**

**Ardita Haxhnikaj - Demi**  
  
**Kryetare e Kolegjit**



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit ██████████;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Arkivit të KPMSHCK-së

